



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:086406
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05742872

Pml.nr.272/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: F. B. dhe J. D., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, nr.2023:086406 të datës 30.11.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.749/2023 të datës 07.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve F. B. dhe J. D. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda 2023:086406 të datës 30.11.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.749/2023 të datës 07.02.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin nr.2023:086406 e datës 30.11.2023, të dënuarit F. B. dhe J. D. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së duke i shqiptuar të dënuarit F. B. dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) €, kurse të dënuarit J. D. i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 (njëmijë) €, kurse në dënimet e shqiptuara u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.04.2023 e tutje. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej nga 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.749/2023 e datës 07.02.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtëse të të dënuarve kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit F. B., avokati Meshari Selimaj nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën të e kthej në rigjykim ose të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë me burgim dhe me gjobë;

- mbrojtësi i të dënuarit J. D., avokati Sh. V. nga Gj., pa përcaktuar bazat ligjore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresat KMLP.II.nr.151/2024 e datës 02.05.2024 dhe KMLP.II.nr.151/2024 e datës 14.05.2024 ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit F. B. thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.10 të KPP-së, meqë gjykatat në fjalë nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe nuk kanë arsyetuar rrethanat nga neni 69 dhe 70 i KPRK-së, por këto rrethana vetëm janë parafrazuar, përkatësisht vetëm është bërë përshkrimi i tyre. Për më tepër, pretendohet se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit që prej fillimit të procedurës penale nuk është marrë fare për bazë, por edhe rrethana tjetër se i njëjti ka shprehur keqardhje, ashtu që duke u referuar edhe në dispozitën për zbutjen e dënimit konsiderohet se në rastin konkret ka mundur të shqiptohet dënimi nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe të edhe për dënimin me burgim por edhe për dënimin me gjobë.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të kundërligjshme ka theksuar si rrethanë rënduese se nga deklarimi i të dënuarit është pohuar fakti se më parë ka qenë i dënuar për veprën penale që lidhet me substanca narkotike në Republikën e Shqipërisë edhe pse një fakti të tillë nuk e ka vërtetuar sipas dispozitave ligjore dhe njëkohësisht nuk e ka vërtetuar faktin se për çfarë veprimesh konkrete ishte dënuar duke pasur parasysh se kanë munguar të dhënat për kohën e kryerjes dhe veprimet konkrete të të dënuarit që ndërlidhen me veprën penale të kryer në Shqipëri.

Kurse në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit J. D. theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm që ndërlidhet me fajësinë e të dënuarit, por as me pjesën që ka të bëjë me lartësinë e dënimit të shqiptuar.

Në vijim të kërkesës pretendohet për shkelje të ligjit penal, meqë në rastin konkret ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të të dënuarit, përkatësisht mungojnë elementet e dashjes dhe paramendimit për kryerjen e kësaj vepre penale. Të paargumentuara kanë mbetur faktet se kinse i dënuari në bashkë veprim dhe duke ndarë rolet me të dënuarin tjetër dhe i dënuari kufirin e paska kaluar nëpër pyll në këmbë duke bartur dy çanta me lëndë narkotike,

kurse i dënuari tjetër F. B. kufirin e paska kaluar me automjetin e tij në pikën kufitare në Q. M. nga Sh. në K.. Gjykata e shkallës së parë nuk jep asnjë argumentim se në këtë mënyrë ka ndodhur ngjarja, por mbështetet vetëm në supozime se në këtë mënyrë ka mundur të ndodhë ngjarja. Kurse faktin se i dënuari kufirin e ka kaluar përmes pyllit duke ecur në këmbë dhe me dy çanta me narkotikë nuk ka mundur të e vërteton me asnjë provë, përkatësisht pamje satelitore apo incizime përmes dronëve, kurse ka anashkaluar faktin se kalimin e kufirit i dënuari e kishte bërë përmes automjetit të të dënuarit tjetër F. B. dhe se xhamat e errësuar në automjet mund të jenë arsyeja që i njëjti nuk është vërejtur nga ana e personave zyrtar. Për më tepër, fakti i mos përfshirjes së të dënuarit në këtë vepër penale vërtetohet edhe me faktin se me rastin e ekzaminimit të gjurmëve të vijave papilare nuk ka mundur të vërtetojnë se janë gjetur gjurmë të gishtërinjve të tij në qese apo çantat që ishin mbushur me narkotik e këtë duke e ndërlidhur me faktin se i dënuari deri më tani nuk ka pasur të kaluar kriminale as në K. e as në Sh. dhe nuk është marrë me këtë veprimtari.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

- kërkesat nuk janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Pretendimet për shkeljen e ligjit penal dalin të jenë të pabazuara, meqë në veprimet e të dënuarve janë realizuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar. Për më tepër, në këtë çështje penale është vërtetuar edhe aspekti i bashkëkryerjes, siç është përcaktuar me nenin 31 të KPRK-së: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.”*

Kurse në rastin konkret del se të dy dënuarit kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, meqë kanë vepruar në një kontinuitet të caktuar kohor dhe secili nga ta ka ndërmarrë veprime të cilat janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe të plotë në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke filluar nga nisja e tyre nga qyteti i T. – R. e Sh. pastaj kalimi i tyre në pikën kufitare Q. M.- pika kufitare Sh. –K. dhe të i dënuari i parë F. B. duke drejtuar automjetin tij të tipit M. B. me targa të regjistrimit ..., kurse i dënuari tjetër J. D. duke kaluar pikën kufitare në këmbë me dy çanta me substancë narkotike dhe pastaj vazhdimi i rrugëtimit deri në Gjakovë ku edhe ndodh ndalimi i automjetit të tyre dhe njëkohësisht arrestimi.

Përtej kësaj bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe në shkresat e lëndës vërtetohet edhe përfshirja e të dënuarit J. D. (meqë i dënuari F. B. kishte pranuar veprimet inkriminuese) dhe atë posaçërisht fakti se bazuar në Sistemin Menaxhimit të Kufirit të pikës së kalimit Q. M. i datës 07.04.2023 është vërtetuar se i dënuari F. B. kufirin e kishte kaluar vetëm duke drejtuar automjetin e tij dhe kjo duke u ndërlidhur me faktin se të dënuarit pikërisht në intervalin kohor 19:59-20:27 minuta kishin komunikuar mes veti me telefonat e tyre dhe kjo e bën në tërësi të pabesueshëm faktin se të njëjtit ishin së bashku në automjet, andaj arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me përfshirjen e të dënuarit J. D. e aprovon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve përkitazi me dënimin e shqiptuar vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar për veprat penale për të cilat të dënuarit janë shpallur fajtor. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore dhe arsytet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit F. B. se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si rrethanë rënduese vet deklarimin e të dënuarit se edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre, kjo rrethanë është trajtuar tek rrezikshmëria konkrete e kësaj vepre penale dhe pa dyshim

se kjo e dhënë e prezantuar nga vet i dënuari nuk ka mundur të anashkalohej dhe të mos trajtohet si rrethanë rënduese, siç e ka theksuar gjykata e shkallës së parë.

Edhe pse kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur kryesisht pretendime përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.272/2024, më 15 maj 2024

B.profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi